



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Drejtësisë (MD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MD kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Pagesat nga subvencionet dhe transferet lidhur me mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave potencial të akuzuar pranë Dhomave të Specializuara të cilat kanë qenë të klasifikuara (niveli i kufizuar) nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretarja e Përgjithshme është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretarja e Përgjithshme është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë

manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Ministria ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 35,204,319€ me një ngritje prej 5% në raport me vitin paraprak.

Fushat për përmirësim janë vërejtur tek shpenzimet, që kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike, eliminimin e vonesave në zotimin e mjeteve, dhe shmangien e vonesave në pagesën e faturave duke parandaluar kostot shtesë në rastet e kontesteve nga operatorët. Po ashtu, janë identifikuar edhe mangësi fushën e menaxhimit të pasurive kapitale dhe jo kapitale.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja dhe dy (2) rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime (me shpenzime komunale) në vitin 2023 ishte 8,900,823€, prej tyre ishin shpenzuar 8,223,603€. Ato kanë të bëjnë me furnizim me ushqim për nevojat e të burgosurve, shpenzime të arbitrazhit, furnizim me material shpenzues, derivate për ngrohje, veshmbathje për stafin korrektues, shërbime komunale, etj.

Çështja B1 - Vonesë në zotimin e mjeteve

Gjetja Sipas nenit 22 të rregullës financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, urdhërblerja, raporti i pranimit të mallit (pranohet malli apo shërbimi) dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në 2 pagesa me vlerë 37,066€, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të faturave. Vonesat ishin deri 20 ditë. Shpenzimet kanë të bëjnë me paisje tjera dhe mirëmbajtje të automjeteve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të jo efikasitetit të kontrolleve të brendshme në parandalimin e vonesave në zotime.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave mund të ndikojë që Ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë që ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, e të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B1 Ministrja duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave duke filluar që nga zotimi e deri tek pagesa e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,355,750€, prej tyre ishin shpenzuar 689,737€. Ato kanë të bëjnë me renovimin e objekteve të burgjeve, depot, blerjen e pajisjeve etj.

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Ne identifikuam klasifikime jo adekuate të shpenzimeve në vlerë prej 57,750€ sin ë vijim:

- Shpenzimet për “Furnizim me Dyshek, Batanije dhe Jastëk Anti-zjarr për institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës” në vlerë 56,400€ ishin paguar nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale, edhe pse për nga natyra dhe vlera për njësi këto shpenzime i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Shpenzimet për instrumentin muzikor të blerë për nevojat e Shërbimit Korrektues në vlerë 1,350€, ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime edhe pse për nga natyra dhe vlera këto shpenzime, i takojnë kategorisë investime kapitale.

Kjo kishte ndodhur për shkak planifikimit jo të duhur të mjeteve me buxhet dhe mos ridestinimit të mjeteve në kategoritë përkatëse konform natyrës së shpenzimit.

Ndikimi

Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, rezulton me raportim apo klasifikim jo të saktë të të dhënave në pasqyra financiare, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi B2

Ministrja duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëjë ridestinim të mjeteve sipas kategorive adekuate të shpenzimeve në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 94,734,318€, pasurive jokapitale është 670,688€, si dhe e stoqeve 618,582€.

Çështja A1 - Nënvlërësim i regjistrave të pasurisë në PFV

Gjetja

Sipas nenit 6 të rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore – Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Po ashtu, sipas Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në nenin 3 përcaktohet që Regjistri i Përgjithshëm i Pasurive - është një listë e plotë dhe e saktë e të gjitha pasurive jo financiare të zotëruara nga organizatat buxhetore, që nënkupton regjistrin e pasurive kapitale, pasurive jo kapitale dhe stoqeve që azhurnohen rregullisht, dhe që, përveç përdorimit për menaxhim të pasurive, do të përdoret edhe për të mbështetur të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare. Ne identifikuam se:

- Pasuritë e blera gjatë vitit 2023 nga Shërbimi korrektues i Kosovës në vlerë prej 22,159€ nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurive. Furnizimet kishin të bënin me Laptop, monitor dhe PC në vlerë 20,809€ dhe instrument muzikor në vlerë 1,350€;
- 11 vetura që i janë dhënë në shfrytëzim Ministrisë nga Agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar në vlerë 158,000€ nuk kishin qenë të regjistruara gjatë vitit 2023. Pas identifikimit të kësaj çështje nga auditimi në muajin maj të vitit 2024 ato ishin regjistruar; dhe
- Informatat për djegjen dhe dëmet e shkaktuara në ndërtesën e Institutit të Mjeksisë Ligjore (IML) nuk ishin shpalosur në PFV e vitit 2023. Kjo ndërtesë ishte djegur në muajin nëntor 2023. Vlera e dëmit nga grupi i ekspertëve të angazhuar me datë 18.01.2024 ishte vlerësuar 198,926€ (me këtë vlerësim nuk është pajtuar Ministria duke aluduar se dëmi është edhe më i lartë, e cila e konteston vlerën e tyre). Kjo ndërtesë nuk kishte qenë e regjistruar si pasuri (vlera fillestare e ndërtesës së IML-së e cila ishte ndërtuar në periudhën 2004-2006 ishte 889,342€).

Mungesa e azhuritit në regjistrimin e pasurive dhe komunikimit jo i duhur në mes të departamentve ka qenë shkak i këtyre mangësive.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive në kohë ndikon në raportimin jo të drejtë të vlerës së pasurive. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlërësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të vlerës së tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi A1

Ministrja duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të evituar nënvlërësimin e pasurive, si dhe të siguroj përmes zyrtarëve të pasurive dhe ZKF që çdo pasuri e blerë apo e ndërtuar dhe dëmtuar të jetë prezantuar saktë dhe në kohën e duhur në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2023 ishte 481,886€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2023. Pjesa më e madhe e obligimeve të papaguara janë për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe pranimit të faturave pas afateve të përcaktuara ligjore.

Çështja A2 - Vonesë në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Tre fatura në vlerë totale prej 198,773€ ishin paguar me vonesë, prej 15 deri 30 ditë, përtej afateve të lejuara ligjore.

Vonesa në pagesën e faturave ishte për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme nga ana e Ministrisë.

Ndikimi Vonesat në pagesën e faturave krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues, ku përveç pagesave të faturave Ministria mund të jetë edhe pjesë e padive nga OE si rezultat i vonesave të mëdha në kryerje të obligimeve të saj.

Rekomandimi A2 Ministrja duhet të siguroj një kontroll efektiv të obligimeve që rrjedhin nga aktivitetet e Ministrisë në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar për të shmangur penalizimet për shkak vonesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2023 ishte 539,192€.

Çështja A3 - Prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Gjetja

Bazuar ne Rregulloren MF nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore (OB), OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Sipas nenit 18 të kësaj rregullore OB duhet të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente. Ne identifikua se:

- Në listën e detyrimeve kontingjente në PFV dy lëndë-padi (lënda nr. 4544/20 dhe lënda nr.74/22) në vlerë 50,018€ ishin prezantuar gabimisht dy herë duke i mbivlerësuar detyrimet kontingjente për këtë vlerë; dhe
- Nga lista e detyrimeve kontingjente vërehet se për disa lëndë tjera nuk dihet se a janë paguar apo ku gjendet statusi i tyre, pasi që nuk ishte bërë verifikimi paraprak i tyre, para se të paraqiten në PFV.

Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo të duhur të përditësimit të listës së detyrimeve kontingjente nga zyrtarët përgjegjës, e po ashtu mungesës së një komunikimi të duhur në mes të Avokaturës Shtetërore dhe departamentit të financave.

Ndikimi

Menaxhimi jo i duhur i detyrimeve kontingjente ndikon që PFV-të të mos prezantohen gjendjen e duhur dhe vlera e tyre financiare të mbivlerësohet, përderisa mos azhurnimi i regjistrit të detyrimeve kontingjente nga lëndët e paguara ndikon që vlera e tyre financiare të mos jetë e saktë.

Rekomandimi A3

Ministrja duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe ZKF, në mënyrë që detyrimet kontingjente para se të paraqiten në Raportim Vjetor Financiar të rishikohen nëse janë paguar, të azhurnohet lista dhe të prezantohen saktë dhe në mënyrë të plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	35,945,052	36,686,596	35,204,319	30,134,916	28,222,191
Grante Qeveritare – Buxheti	35,864,852	36,532,812	35,161,315	30,068,326	28,190,019
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	45,108	11,221
Të bartura nga viti i kaluar	0	30,885	30,885	1,096	1,641
Të hyrat vetanake	80,200	80,200	0	16,406	19,310
Donacionet e jashtme	0	42,699	12,120	3,981	0

Buxheti final i Ministrisë së Drejtësisë është më i lartë se buxheti fillestar për 741,544€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2023, MD ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar ose 35,204,319€ me një ngritje prej 5% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	35,945,052	36,686,596	35,204,319	30,134,916	28,222,191
Pagat dhe mëditjet	14,541,948	15,505,923	15,424,957	13,079,738	13,301,515
Mallrat dhe shërbimet	8,884,335	7,786,054	7,245,277	7,141,384	6,112,369
Komunalitë	1,264,769	1,114,769	978,326	1,004,225	1,040,780
Subvencionet dhe transferet	9,748,000	10,924,100	10,866,022	7,999,623	7,104,392
Investimet Kapitale	1,506,000	1,355,750	689,737	909,946	663,135

MD kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 963,975€. Kjo rritje ishte pasi që Shërbimi Korrektues në fillim të vitit kishte ndarje buxhetore jo të mjaftueshme dhe me rregullime të brendshme janë reflektuar në buxhetin final. Shpenzimi në këtë kategori ishte 99% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,098,281€. Kjo ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore. Ekzekutimi i buxhetit tek kjo kategori ishte 93%;
- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 150,000€. Kjo ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 88%. Pjesa e paspenzuar e buxhetit ka të bëjë me faturat që kanë ardhur për pagesë pas mbylljes së vitit fiskal;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,176,100€. Kjo ishte edhe si rezultat i kërkesës për mjete shtesë për Avokatët e të akuzuarve si dhe shpenzimet e familjarëve të tyre. Shpenzimi në këtë kategori ishte 99% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 150,250€, ky buxhet ishte realizuar në një nivel prej vetëm 51%. Në këtë nivel të realizimit kanë ndikuar që për disa aktivitete të prokurimit ka pasur ankesa në OSHP dhe vendimet e kësaj të fundit janë marrë në fund vit, ku janë nënshkruar kontratat por që nuk janë realizuar brenda vitit 2023. Po ashtu, kishte edhe raste kur aktivitetet e prokurimit ishin anuluar për shkak të mungesës së buxhetit për vitin 2024.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga MD në 2023 ishin në vlerë 106,343€. Të hyrat realizohen nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas vendimeve të Gjykatave, nga provimi i Jurisprudencës dhe noterisë dhe nga kompensimet e dëmeve nga kompania e sigurimeve.

Krahasuar me vitin e kaluar shohim një rënie të inkasimit të konsiderueshme të të hyrave për 90%, kjo për shkak të rënies së të hyrave nga konfiskimet në vlerë 964,865€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	524,796	524,796	106,343	1,085,091	127,803
Të hyrat jo tatimore	524,796	524,796	106,343	1,082,012	127,803
Të hyrat tjera	0	0		3,079	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Ministrisë së Drejtësisë ka rezultuar me katër (4) rekomandime. MD kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria për vitin 2023 po ashtu kishte përgatitur një raport periodik për progresin në zbatimin e rekomandimeve ku janë paraqitur veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, një (1) rekomandim është implementuar, dy (2) rekomandime nuk janë adresuar dhe një (1) rekomandim nuk është i aplikueshëm më.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministrja duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm sa i përket regjistrave të pasurive si dhe në bashkëpunim me Thesarin/MFPT të sigurojë se vlera pasurive e paraqitur në PFV e vitit 2023 të jetë e saktë dhe e plotë. Po ashtu, Ministrja duhet të sigurojë që të gjitha proceset rreth tjetërsimit/shitjes së pasurive kapitale realizohen në pajtim me kërkesat ligjore.	Kjo çështje është trajtuar dhe fuzionuar te kategoria e pasurive. shih çështjen A2.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të sigurojë se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregulloret në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të bëhet pranimi i mallit/shërbimit dhe faturës.	Gjatë vitit 2023 kemi identifikuar raste të tilla.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëjë ridestinin të mjeteve sipas kategorive adekuate të shpenzimeve në përputhje me planin kontabël.	Gjatë vitit 2023 kemi identifikuar raste të tilla, tek kategoria e investimeve kapitale dhe mallra shërbime.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që komisionet përkatëse pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjnë harmonizimin me gjendjen në regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve, me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen e saktë të pasurive me të cilat disponon ministria. Po ashtu, duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë nën 1,000€ janë të regjistruara në sistemin e pasurisë duke përfshirë edhe të gjitha pasuritë nga regjistrat e verzionit të vjetër të sistemit.	Gjatë auditimit të vitit 2023 kemi vërejtur se ishte bërë harmonizimi i regjistrave të pasurisë.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Gazmend Namani, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Letër konfirmimi

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTERSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

Nr.BrNo: 01-1048

Data/Datum/Date: 06/06/2024

Shtojca/Dodaci/Annex: -1-

PRISHTINE

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

NUMER I PROTOKOLLIT / NO. OF PROTOCOL: - 6-06-2024

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47 778 1



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministra Pravde – Office of Minister of Justice

Data: 06/06/2024

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2023;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,


 Albulena HAXHIU
 Ministre e Drejtësisë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.